

Besimtari

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkodër
Viti III i botimit, Shtator 2009 Nr. 29. Çmimi 20 lekë.
www.gazetabesimtari.com; e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it

Kryeredaktor Selim Gokaj

EVROPA RACISTE KUNDER TURQISE MUSLIMANE

Problemi i anëtarësimit të Turqisë në BE është një problem që i ka kaluar përmasat e thjeshta të anëtarësimit të një vendi në këtë organizëm të rëndësishëm evropian, sepse këtu bëhet fjalë jo për mosplotësim të standarteve nga Turqia, por për paragjykitje raciste të krishtera nga shtetet që kanë rëndësi të vecantë të BE. Të mos harrojmë se Turqia ka më se një dekadë që ka aplikuar për t'u bërë anëtare me të drejta në BE, kërkesë që i është refuzuar dhe vazhdon të refuzohet përsëri me argumente të paqena dhe fallso, në një kohë që arsyeja e vërtetë përse Turqia vazhdon të mbetet jashtë dyerve të BE është përkatësia muslimane e popullit turk e cila është thujtë absolute. Në përpjekjet e saj për t'u integruar dhe për të pohuar se është larg paragjykitjeve, Turqia vazhdon të këmbëngulë në kërkesën e saj për të qënë pjesë e BE, e sigurtë se ajo i plotëson kërkesat për të qënë pjesë e familjes së madhe evropiane. Qeveritë turke, që kanë pasuar njëra tjetrën në këto pesë dekada, e kanë pasë kërkesën për të hyrë në BE pjesë të rëndësishme të politikës së tyre të jashtme, por që cuditërisht Evropa e ka refuzuar pa dhënë haptas arsyen e vërtetë të këtij refuzimi. Por, opinjoni politik në Turqi dhe më gjërë e ka të qartë arsyen e mospranimit të shtetit turk në rrallët e BE, sepse demonstratat në shumë vende të BE kanë kërkuar që Turqia të qëndrojë sa më larg Evropës, pavarësisht në se i plotëson apo jo standartet. Të ashpër në demonstrata u treguan austriakët dhe francezët, pa harruar se demonstrata kundër pranimit të Turqisë në BE nuk munguan thujtë në të gjitha vendet e BE duke treguar se evropianët vazhdojnë të jetojnë me frikën e Perëndorisë Osmane, duke harruar se Turqia e sotme nuk është Perëndoria Osmane. Sikur të mos mjaftonin demonstratat antiturke, në Evropë, flamurin kundër Turqisë e morën në dorë politikanë që kanë potencë të një rangu të lartë si është presidenti i Francës, Nikollë Sarkozy (për saktësi kuptimi emrin e shqiptarizuar), pa harruar dhe politikanë të tjerë ku austriakët janë ndër të parët që e mbajnë në duar "shko-



pin kundër Turqisë'. Kjo politikë e egër dhe përjashtuese e vendeve evropiane ka bërë që edhe politika turke të marrë me të drejtë rolin e demaskuesit për këto qëndrime duke deklaruar haptas arsyen e vërtetë të lënies jashtë të saj nga vendet evropiane. Ish kryeministri i Turqisë, Mesud Izzetoglu, në një prononcim mediatik, duke komentuar qëndrimin e BE për këtë problem e quajti BE "një klub i krishterë" duke rrëzuar maskat dhe duke nxerrë kështu të vërtetën e saktë të përjashtimit të kandidatures së Turqisë në BE. Në një linjë të tillë është edhe kryeministri aktual i Turqisë, Taip Rexhep Erdogan, i cili i ka kërkuar vendeve evropiane që të bëjnë publike arsyet e vërteta që vazhdojnë të mbajnë larg BE shtetin turk. Por, Erdogan nuk ka ngurruar të deklarojë publikisht se nuk do të shembet bota edhe nëse Turqia nuk pranohet në BE duke bërë publik faktin se BE nuk është

e vetmja alternativë për Turqinë që ajo të kapë majat e arritjeve dhe të zhvillimit. Qeveria e Turqisë ka deklaruar se ajo do të plotësojë vetëm ato standarte që nuk prekin interesat e popullit turk dhe të vetë shtetit turk. Duket se BE i trembet një shteti kolosal ekonomik dhe ushtarak në rrallët e saj, aq më tepër që ky shtet është me një popullsi dominante muslimane. Kur shohim shtete lillipute dhe me zhvillim foshnjor që janë pjesë e BE dhe Turqia, që po synon në dekadat e ardhshme të jetë superfuqi, jashtë BE, Ne duhet të pranojmë se BE po përdor dy standarte për zgjerimin e saj duke diskriminuar vendet me popullsi dominante muslimane si u veprua me liberalizimin e vizave në rastin e Shqipërisë, Kosovës, Bosnjës dhe vetë Turqisë. Por nuk kanë munguar edhe zërat kundër qëndrimit që po mban BE, kur është fjala për anëtarësimin e Turqisë në këtë orga-

nizëm të fuqishëm ndërkombëtar. Gazeta britanike "Economist" pohon se Turqia është një pasuri e madhe për BE, sepse ky komb ka lidhje të fuqishme me botën islame, me Iranin e fuqishëm, me Sirinë dhe me vende të Azisë që kanë një rëndësi të vecantë për Perëndimin. Gazeta britanike vazhdon komentimin duke thënë se vendet e BE duhet të heqin dorë nga frika që ata kanë nga islami, sepse një Turqi në BE do të ndihmojë për uljen e tensioneve në Lindjen e Mesme. Pavarësisht në se hyn apo jo Turqia në BE, një gjë është shumë e sigurtë. Turqia është një vend që, sipas parashikimeve të shoqatës amerikane "Stratfor" e cila bazohet në parametrat egzistuese që ka rritur Turqia në të gjitha fushat, në 100 vitet e ardhshme Turqia do të jetë forca dominuese në botë në fushën ushtarake politike dhe financiare.

Selim Gokaj

GËZUAR MUAJIN E MADHËRUESHEM TE RAMAZANIT

AKTIVITETE NE KUADRIN E MUAJIT TE MADHERUESHEM TE RAMAZANIT

AKTIVITET I SHOQATES "BURIMI" NE TEATRIN MIGJENI

Shoqata Kulturore Humanitare "Burimi" ka organizuar në teatrin "Migjen" një aktivitet në kuadrin e aktiviteteve për muajin e madhnueshëm të Ramazanit me emërtimin intrigues "Mirë se vjen Ramazan" i cili ishte portretizuar me të drejtë si muaji i vlerave dhe i mirësive. Për besimtarët muslimanë dhe për të pranishmit, të cilët kishin mbushur sallën e teatrit "Migjeni" ishte surprizë ardhja nga Maqedonia e dy këngëtarëve të njohur të ilahive, vëllezërve muslimanë, Adem Ramadani dhe Ferki Shala dhe e teologut të njohur të

trevave shqiptare, vëllaut musliman, Bekim Halimi.

Aktiviteti u përshëndet nga drejtori i shoqatës "Burimi", Sokol Mandi dhe muftiu i qarkut Shkodër, Ndricim Sulejmani, në një kohë që aktivitetin e hapi teologu Altin Loshi. Të pranishmit ndoqën më interesim bisedat fetare që ishin programuar në këtë aktivitet, ku një përshtypje të vecantë bëri ajo e mbajtur nga teologu Bekim Halimi me temën "Vlerat shpirtërore dhe edukative të Ramazanit". Interes të madh paraqiti edhe kumtesa e teologut Gilman Kazazi "Agjërimi, ndikimi i tij në aspektin shëndetësor." Por ngjyrën emo-

cionale fetare aktivitetit ia dhanë këngëtarët e ilahive, Adem Ramadani dhe Ferki Shala të cilët, me zërin e tyre brilant, që pasurohej dhe bëhej edhe më i bukur nga përmbajtja e ilahive, krijuan në sallë një atmosferë të vecantë fetare të cilën të pranishmit e përjetuan emocionalisht. Duhet theksuar se aktiviteti ishte shumë mbresëlënës për të pranishmit të cilët ishin kaq të shumtë në numur, sa hapësira e teatrit Migjeni ishte e pamjaftueshme për të sistemuar të gjithë të pranishmit. Ky aktivitet tregoi se sa të rëndësishme janë nisma të tilla fetare, sepse faktikisht ata janë vetëm fetare, pavarësisht se

emërtohen si pjesë humane dhe kulturore si i thojne një fjale "sa për të qenë mbrenda rregullit të pashkruar", për të bërë që besimtarët muslimanë ta shohin vehten në një mjedis ku vëllazëria muslimane e dominon hapësirën. Në përpjekje për të ruajtur ngjyrën fetare të aktivitetit, organizatorët kishin parashikuar që gratë ta ndiqnin aktivitetin të ndarë nga burrat, një veprim ky i motivuar nga këndi që e shikuan karakterin e aktivitetit drejtuesit e shoqatës Kulturore Humanitare "Burimi"

NJE IFTAR NGA SHOQATA KULTURORE "DRITA"

Shoqata kulturore "Drita" me drejtues të saj, Bujar Shehu, këto ditë të madhnueshme të muajit Ramazanit ka shtruar një iftar për besimtarët muslimanë të qytetit të Shkodrës në ambjentet e hotel "Rozafa", ku pjesëmarrësit ishin besimtarë nga rrallët e intelektualëve dhe qytetarë të tjerë të nderuar muslimanë. Përshëndetjen për të pranishmit e bëri pedagogu i Universitetit të Shkodrës, Pr.Dr. Bajram Xhafa. Pak momente më vonë u kënduan vargje nga Kurani Famëllartë nga drejtori i Vakëfit Turk në Shqipëri, Shukri Kapllan. Iftuar në këtë iftar ishte edhe presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bamir Topi i cili në fjalën e tij përshëndetëse falenderoi organizatorët për ftesën e bërë dhe vuri në dukje rëndësinë që ka muaji i madhnueshëm i Ramazanit për besimtarët muslimanë si muaj i sakrificës dhe i vetmohimit që bëhet për hir të Allahut xh.sh. Gjithashtu, presidenti i Republikës së Shqipërisë vuri në dukje se në Shqipëri është

të njohur tolerance fetare dhe bashkëegzistenca fetare në mes të religjoneve. Pasi u këndua dua, të pranishmit filluan iftarin i cili ishte shumë i pasur në asortimente dhe në cilësi, Ambjenti i krijuar në këtë mjedis fetar na e forcoi idenë se iftarët janë momente bashkimi dhe solidariteti në mes të besimtarëve muslimanë të cilët, në hapësirat e iftarit janë pranë njëri tjetrit duke forcuar miqësinë në mes të tyre dhe duke mos harruar se e gjitha kjo bëhet për hir të Allahut xh.sh. Mendojmë se duhen falenderuar edhe sponsorët që bënë të mundur bërjen e këtij iftari, i cili bëri që besimtarët muslimanë të kalojnë momente që janë te vecanta dhe që nuk kanë të bëjnë thjesht me një darkë ku të pranishmit e ndjejnë kënaqësinë vetëm duke ngrënë, por që realisht kënaqësia e vërtetë është se ata janë bashkuar në një ambjent fetar që është dukuri e përkushimit ndaj Krijuesit të Gjithësisë.



INFORMACIONE MEDIATIKE NGA "ZERI I TURQISE"

GREQIA KERRKON BASHKEPUNIM ME TURQINE

Kryeministri aktual i Greqisë, Kosta Karamanlis, ne nje prononcim për mediat gjatë vizitës së tij në panairin ndërkombëtar të Selanikut foli për bashkëpunimin e Greqisë me vendet e rajonit. Kryeministri Karamanlis i kushtoi një rë-

ndesi të vecantë lidhjeve dhe bashkëpunimit me Turqinë si vendi më i rëndësishëm i rajonit duke theksuar se ky bashkëpunim është vecanarisht në interes të Greqisë dhe të vetë rajonit të Ballkanit. Kjo deklaratë e kryeministrit grek merr rëndësi në këto momen-

te, sepse një politikë e fgjinjësisë së mirë ne mes të këtyrë dy shteteve, që janë anëtarë të Aleancës së Atlantikut Verior dhe njëkohësisht shtete që kanë probleme të trashëguara nga e kaluara, do t'i shërbente edhe vetë forcimit të kësaj aleance e cila është e

interesuar që situatë mbrenda aleancës të jetë pa probleme. Le të shohim sa kanë qenë të sinqerta deklaratimet e kryeministrit Karamanlis për miqësi dhe fqinjësi të mirë me Turqinë.

ERDOGAN PER MARDHENIET E TURQISE ME IZRAELIN

Në një intervistë që i dha revistës amerikane "News week", kryeministri i Turqisë Taip Rexhep Erdogan ka dhënë informacione të rëndësishme dhe detaje të reja për nivelin e mardhënjeve të Turqisë me shtetin izraelit . Erdogan ka theksuar se Hamasi nuk është dora e zgjatur e Iranit, sepse në zgjedhjet e fundit parlamentare ka marrë pjesë si parti politike dhe ka fituar, por bota nuk ka respektuar vullnetin e popullit palestinez, duke mos e njohur Hamasin si fitues të zgjedhjeve. Sot, Palestina është një burg i hapur, ku nuk respektohet vullneti politik i popullit palestinez. Unë e kam pyetur kryeministrin izraelit, Olmer, se sa njerëz kanë vrrarë raketat palestineze, në një kohë që janë

vrrarë 1300 paletinezë dhe janë plagosur 6000 të tjerë dhe, kur OKB merr vendime, Izraeli nuk i zbaton. Të mos harrojmë se ka shumë njerëz që përpiqen të më akuzojnë për antihebre për shkak të qëndrimit timn ndaj sulmeve të Izraelit në Gaza.

Më kanë thënë se hebrejtë në SH.B.A. janë të shqetësuar nga qëndrimi im ndaj qeverisë izraelite. Por, ata dhe të gjithë hebrejtë duhet ta dine se unë e quaj krim kundër njerëzimit antisemitizmin si në Turqi, ashtu edhe në të gjithë botën. Përplasja ime ka të bëjë vetëm me qeverinë izraelite e cila nuk na trajton drejt. Duhet pranuar se ka raste të rralla antisemitizmi edhe në Turqi që kanë kulmuar me sulme mbi konsullatën izraelite dhe janë bërë protesta anti-izraelite ne Turqi si në të gjithë



botën. Unë do të jem në mbrojtje të hebrejve në Turqi e më gjërë, por nuk do të pyes kryeministrin Olmer se si t'i shkruaj fjalimet e mia. Ne nuk jemi për mbylljen e mardhënjeve me Izraelin, por presim që qeveria e Izraelit të shikojë qëndrimin e saj. Për mua nuk ka drejtësi deri tashti ndaj palestinezëve. Të

shohim nëse presidenti Obama do të vendosë drejtësi me lëvizjet e tij politike që do të bëjë në të ardhmen.

Nga intervista e dhënë revistës javore amerikane "News Week"

MEDIAT PERENDIMORE PER ANETARESIMIN E TURQISE NE BE

Në emisionin "Zëri i Turqisë në gjuhën shqipe" është dhënë një koment i mediave perëndimore për anëtarësimin e Turqisë në Be ku theksohet se tashmë Be duhet ta kuptojë që anëtarësimi i këtij vendi me potencial të madh njerëzor, ekonomik dhe politik është bërë më shumë një domozdoshmëri për vetë BE se sa për Turqinë. Mediat ne këtë kontekst vënë në dukje se BE duhet ta ketë parasysh faktin

se Turqia është një shtet i fuqishëm që ka lidhje specifike dhe shume të ngushta me Botën Islame, ku vend të rëndësishëm zënë mardhënjet që ka sot Turqia me Iranin dhe Sirinë të cilët janë dy vende me të cilat bota perëndimore ka probleme të cilat për momentin janë të pakapërcyeshme. Në këtë aspekt, një Turqi e anëtarësuar në BE do të luan-te nje rol të rëndësishëm në stabilizimin e rajonit dhe do të krijonte lehtësira dhe mu-

ndësi për të ulur në tryezën e bisedimeve këto shtete që i janë bërë barrierë poplitikave perëndimore në rajon. Mediat perëndimore i kujtojnë BE që të heqë dorë nga mosrespektimi standarteve në politikat e saj të cilet ajo vetë i ka aprovuar dhe i ka pranuar. Ka ardhur koha që BE të lrgojë nga vehtja frikën nga islami dhe të heqë dorë nga islamofobia, sepse qëndrime të tilla më shumë e rëndojnë procesin e anëtarësimit të Turqisë në

BE dhe për pasojë i bëjnë një portret jo miqësor kësaj organizate në botën muslimane e cila e shikon vehten të penalizuar dhe të kërcënuar nga ky qëndrim që me ose pa dashje po behet hallkë e fortë në zinxhirin që qarqe dhe segmente të caktuara po bëjnë përpjekje që t'ia vendosin në qafë botës islame në përpjekje për të zvogluar frymëmarrjen e saj ne sferën politike, ekonomike dhe shoqërore

LUFTIME TE ASHPRA DHE KRIME NE AFGANISTANIN MUSLIMAN

VRASJE MASIVE E CIVILEVE MUSLIMANE

Plan i ri i presidentit të ri amerikan për të "stabilizuar" gjendjen në Afganistan nuk i ka pakësuar viktimat në mes të civilëve të popullatës muslimane, përkundrazi i ka shtuar viktimat. Ajo që të bën përshtypje është se shtimi i vazhdueshëm i trupave amerikane në Afganistan ka sjellë edhe shtimin e viktimave në mes të civilëve muslimanë duke vënë kështu në dyshim idenë për një politikë të re të administratës së re amerikane

ne ndaj muslimanëve në Botë. Axlensitë e lajme sapo kanë dhënë informacion për një operacion ajror të forcave të NATO ku janë vrarë 50 civilë muslimanë, lajm ky i konfirmuar nga organet ushtarake afgane, në një kohë që stacione televizive të ngjyrave të ndryshme nuk mungojnë të deformatojnë vertetesinë e këtij lajmi duke heshtur për viktimat në mes të civilëve muslimanë. Një shtrembërim të tillë bëri "Vizion Plus" në lajmet e orës 12 të datës 4 shtator

2009, në një kohë që Top Cenell pohoi vrasjen e civilëve muslimanë po në të njëjtën orë dhe po në të njëjtën datë. Departamenti amerikan i mbrojtjes ka deklaruar se qytetarët amerikanë që janë kundra luftës janë rritur në numur duke formuar një përqindje të konsiderueshme që është kundër luftës në Afganistan. Ata e kanë quajtur atë një luftë pa kuptim. Është e qartë se kjo protestë kundër luftës në Afganistan në rrallët e qytetarëve amerikanë e ka bazën edhe

tek numuri në rritje e viktimave në rrallët e ushtarëve amerikanë të cilat janë në rritje të vazhdueshme, duke treguar se politika e presidentit të ri amerikan për radikalizimin e luftës në Afganistan nuk ka mbështetjen e mjaftueshme të vetë qytetarëve amerikanë, pa harruar edhe shqetësimin në rritje të botës muslimane për krimet që po bëhen ndaj civilëve muslimanë në Afganistan.

QYTETARET AMERIKANE KUNDER LUFTES NE AFGANISTAN

Protesta dhe revolta e popullit amerikan kundër luftës që po bëjnë forcat të ashtuquatura antiterror në Afganistan tashmë është present në mediat e shkruara dhe ato vizive duke i dhënë këtyre protestave pamje më të qarta dhe më të ashpra. Ditët e fundit gazeta e njohur amerikane "Uashington Post" organizoi një anketë duke pyetur 1000 qytetarë amerikanë të moshave të ndryshme dhe të profesioneve të ndryshme se

cfarë mendonin ata për luftën në Afganistan. Rezultatet ishin të papritura sepse një ndër dy amerikanë ishin kundër luftës që bëhet në Afganistan duke e quajtur atë luftë një veprim i pakuptimtë dhe nga ana tjetër të anketuarit kërkonin kthimin e ushtarëve amerikanë në shtëpiat e tyre. Kjo anketë testoi faktikisht sa e mbështet populli amerikan aventurën ushtarake në Afganistan ku flitet për betejat të ashpra në mes të forca-

ve të koalicionit që udhëhiqen nga amerikanët dhe forcave të rezistencës afgane që përfaqësohen nga luftëtarët talebanë që po etiketohen nga mediat perëndimore si forca terroriste. Janë pikërisht këto forca që po detyrojnë forcat e koalicionit që të kërkojnë kanale dhe mundësi për bisedime në pamundësi për të thyer rezistencën në rritje të forcave të rezistencës afgane. Anketime të tilla nuk janë të veçuara në mediat amerikane sep-

se shqetësimi në SHBA po rritet kundër luftës që kohët e fundit po merr përmasa shqetësuese që ka sjellë edhe rritjen e numurit të viktimave në rrallët e trupave të koalicionit. Ky anketim, që tregon se 50% në SHBA janë kundër luftës në Afganistan, duhet t'i tërheqë vëmendjen presidentit Obama për të gjetur rrugë të tjera për të ndaluar këtë luftë të padrejtë në Afganistan

Alban Kastrati

BASHKEPUNIM I RREZIKSHEM USHTARAK RUSO-AMERIKAN

Presidenti amerikan kabere një vizite në Rusi në përkrahje për të shuar mosmarrëveshtjet që nuk janë të vogla në mes të Rusisë dhe të SHBA, ku sistemi atirakete në Evropë dhe problemi gjeorgjan janë pikat ku distanca në mes të këtyre dy supershteteve për keto dy probleme po vazhdon të rritet. Por, ajo që të ben përshtypje është se, kur është problemi për të shternguar lakunë qafen e muslimanëve, dy "tigrat e medhenj" e gjejnë gjuhën e përbashkët. Në kuader të këtij bashkëpunimi, Rusia ka rënë dakort që të vere në dispozicion të ushtrisë amerikane, që vepron në Afganistan, territorin e saj, duke u krijuar mundësi trupave ameri-

kane që të transportojnë materjale ushtarake nëpër territorin rus të cilat perdoren direkt në fushëbetejat e ashpra që po zhvillohen sot në hapësirat e Afganistanit, ku mijra trupa amerikane dhe të Organizatës së Atlantikut Verior janë angazhuar në një luftë shfarosëse kundër luftëtarëve muslimane talebane, të etiketuar "si terroriste". Të mos harrojmë se në inkursionet ushtarake të "trupave të koalicionit" janë vrarë qindra civilë të pafajshëm, ku numuri i femijve sa vjen dhe po rritet, aq sa ka detyruar edhe qeverinë vasale të Kabulit që të reagojë kundër krimeve ndaj civilëve të kryera nga aviacioni ushtarak amerikan gjatë inkursioneve për

"të mundur terroristet talebane". Ky bashkëpunim në mes këtyre dy supershteteve, që sot dominojnë politikisht dhe ushtarakisht botën, kundër luftëtarëve muslimanë në Afganistan, tregon për një konspiracion të madh ndërkombëtar kundër Botes Muslimane për të cilin deshmon edhe kundërshtimi i eger dhe i hapur kundër pjesëmarrjes së Turqisë në Bashkimin Evropian, ku violine e pare në këte kundërshtim është Franca e Sarkozisë. Presidenti i ri amerikan po luan me "degen e ullurit" dhe me "kerbacin" kundër Botes Muslimane. Në Irak, ku duket se janë realizuar parametrat kryesorë të strategjisë amerikane në këte hapësirë,

premtohet për tërheqje trupash ushtarake. Kurse në Afganistan, ku rezistenca e luftëtarëve muslimanë talebane është në rritje, aty shtohen trupat ushtarake dhe ndërmerren operacione të një shkalle të papare deri tashti. Prandaj, ky bashkëpunim ushtarak ruso-amerikan nuk mund të sjellë paqe të vertete në hapësirën afgane. E vetmja alternative në Afganistan mbetet tavolina e bisedimeve, ku duhet të realizohet zgjidhja afatgjate pasi të dy palët të kenë pranuar kushtet që do të kenë përcaktuar dhenien fund të konfliktit dhe ndalimin e vrasjeve që po rritet në mënyrë të frikshme në rrallët e dy paleve. Selim Gokaj

KUJT U DUHEN INFORMACIONET PER ISLAMIKE TE VRARE

Eshtë bërë i njohur fakti se mediat tona të shkruara dhe vizive nuk kanë hezitur të japin informacione nga teatri i luftimeve që po bëhen sot në shumë hapësira ku popullsia me shumicë muslimane lufton kundër forcave të huaja, ose si quhen ndryshe forca pushtuese dhe kundër qeverive vendase që janë vasale të politikave të huaja, ose janë montuar në pushtet pike-rikt nga këto pushtues. Dhe këto fushëbeteja kanë sot një shtrirje të pamatë që fillon nga hapësirat muslimane në Kaukaz dhe zgjatet deri në Somalinë e largët. Është i njohur fakti se mediat ndërkombëtare janë të interesuara të penalizojnë ata forca që luftojnë kundër të huajve dhe atyre që janë bërë vasalë të tyre, sepse këto media janë

të lidhura me njëmijë fije me përpjekjet që po bëhen për t'u imponuar vendeve muslimane zgjidhje që janë kundër interesave të këtyre vendeve. Mjafton që të kërkosh informacion të tillë dhe do të kesh material me bollek. Në një informacion rutinë që po ndëgjoja tek stacioni radiofonik i Tiranës, u dha një lajm për disa "rebelë islamikë" të vrarë çëçenë nga një repart i forcave speciale ruse. Informacioni në fjalë më shqetësoi dhe më hidhëroi, sepse lajme për vrasjen e muslimanëve janë bërë të shpeshta dhe kanë marrë statusin e qytetarisë në mediat tona, të cilat harrojnë se ne si shqiptarë me popullsi shumicë muslimane, nuk na bëhet qejfi që diku vriten muslimanë vetëm se duan të jetojnë të lirë dhe të qeverisen si duan ata vete dhe jo si duan ata që montojnë "demokra-

ci" me topa dhe raketa. Të mos harrojmë se informacione të tilla, që na përcjellin mediat tona, janë thikë me dy presa, sepse jo vetëm që penalizojnë muslimanët që luftojnë për liri, por njëkohësisht penalizojnë edhe popullsinë muslimane në Shqipëri duke e bërë edhe atë pjesë të këtij rebelimi musliman që, sipas mediave të huaja dhe të mediave tona, që u rrijnë gati këtyre lloj informacionesh, ka përfshirë botën përmes luftëtarëve që quhen pa të drejtë dhe qëllimisht "Rebelë", në një kohë që rebelë janë ata që vrasin luftëtarët muslimanë dhe popullsinë muslimane.

Ne shqiptarët, sidomos muslimanët, nuk duam të indroktinohejmë me islamofobi nga mediat, sepse jemi lodhur shumë me indroktimin komunist që na bëri diktatura kundër ideologjisë borgjeze, e cila

duket se kërkon të na kthejë reston duke na indroktinuar me urrejtjen kundër muslimanëve. Duket se ky indroktinim po ndeshkohet edhe nga administrata e re e presidentit Obama që kërkon paqë dhe mashkëpunim me botën islame. Por, si gjithmonë mediat tona e kanë të vështirë "të marrin kthesën", sepse duket që timonin ua lëvizin qendra të fuqishme antiislame, që janë sot afër, ose larg Shqipërisë. Allahu ua haptë sytë dhe ua sjellte mend në kokë mediave shqiptare që të jenë shqiptare dhe vetëm shqiptare në dhenien e informacioneve për publikun shqiptar dhe me gjere.

Alban Kastrati

RAPORTI REAL I LINDJES MUSLIMANE ME PERENDIMIN E KRISHTERE

Pas ngjarjeve të 11 shtatorit, shumë institucione në Perëndim u orjentuan në krijimin e njëlloj konfrontimi me Botën Islame, i cili filloi me sulmin në Afganistan, duke vazhduar pastaj me plane për një ndëshkim të një grupi të vendeve muslimane dhe më pas me plane të tjera për të persekutuar vetë obsionin islam, në një kohë që Islami nuk kishte asnjë lidhje me veprimet që u ndërmoren me 11 shtator në

SHBA. Por, Perëndimi do të jetë përgjegjës për pasojat që do të ketë në të ardhmen krijimi i këtij konfrontimi me vendet islame, i cili mund të jetë me më pasojë se ata që ndodhën me 11 shtator të vitit 2001 në SHBA, gje nuk do t'u sjellë asgjë të mire të dy palëve. Koncepti i raportit të Islamit me Perëndimin është përmbledhur në dy ajete të Librit të Allahut të Lartësuar.

"Allahu nuk ju ndalon të bëni mire dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë

dhe as nuk ju dëbuan nga shtëpiat e juaja. Allahu i do ata që mbajnë drejtësinë. Allahu ua ndalon t'u afroheni vetëm atyre që ju luftuan për shkak të fesë, që ju nxorën prej shtëpive tuaja dhe që ndihmuan dëbimin tuaj; ju ndalon të miqësoheni me ata. Kush miqësohet me ata, të tillë janë dëmtues të vetvetes."

Këto ajete kuranore janë vizioni islam i cili për këto raporte kërkon të ruhen interesat e përbashkëta të dy palëve dhe raportet me Pe-

rëndimin duhet të jenë kurdoherë në korniza të matura, sepse Perëndimi nuk është i gatshëm të njohë raporte të tilla me Islamin.

Islami është mesazh udhëzimi për mbarë njerëzimin dhe Perëndimi do të ishte mire që t'i kuptonte mesazhin e Islamit.

Materjali është shkëputur nga botimi "Përse frikësohen nga Islami"

i dijetarit arab Selman ibn Fahd el -Avde

TE BURGOSUR PA GJYGJ NE ARABINE SAUDITE

Stacioni radiofonik BBC ka dhënë një lajm të rende, sipas të cilit, komisioni për të drejtat e njeriut është i shqetësuar për zbatimin e ligjit i cili është i cënuar nga autoritetet saudite që mbajnë të arrestuar me mijra qytetarë sauditë të

cilët, nën maskën e luftës kundër terrorizmit, ka vite që nuk nxirren para gjyqit. Në këtë mënyrë ky shtet shkel në mënyrë të hapur të drejtat e njeriut, sepse duhen ngritur akuza të qarta dhe nuk duhen mbajtur qytetarët të burgosur me akuza të dyshimta.

Komisioni për të drejtat e

njeriut i ka kujtuar Arabisë Saudite se veprime të tilla e penalizojnë këtë shtet para opinionit publik ndërkombëtar për veprime që janë sa të denueshme, aq edhe të papranueshme nga bota e qytetëruar që respekton ligjet dhe të drejtat e qytetareve të cilat nuk duhet të cenohen, por du-

het të respektohen në të gjitha rastet, sidomos kur behet fjale për qytetare të arrestuar për fajë që mbeshteten në fakte të dyshimta.

Materjali është marre nga BBC në shqip

JETE MES NJEREZVE DR. MUHAMET BALA (1922-1993)



Dr. Muhamet Bala bën pjesë në atë plejadë mjekësh të njohur që me guxim e përkushtim hodhën bazat e konsolidimit të institucioneve shëndetësore dhe të mjekimit në rrethin e Shkodrës dhe më tej. Dr. Bala studioi për mjeksi në Sarajevë e Budapest në periudhën 1946 - 1953. Shërbeu si mjek fillimisht në Vlorë, pastaj në Hajmel, në Breg të Lumit të Dukagjinit, por në periudhë më të gjatë në spitalin "Jorgji Karamitri" të Shkodrës. Caktohet infeksionist në një kohë kur reparti infektiv shkëputet nga struktura organizative me repartin e patologjisë. Kësisoj Dr. Bala bëhet i pari mjek infeksionist për Shkodrën dhe të gjithë Veriun

dhe njëherësh shefi i parë infeksionist. Dhe më e vështirë bëhet për të kur u vendos që reparti infektiv t'i aneksohet edhe pediatria infektive. Për vite të tëra do të përballojë me vullnet dhe profesionalizëm krejt i vetëm, në pritje të ardhjes së kolegëve me të cilët do të rrisë punën dhe kualifikimin. I kudondodhur, në spital, në shërbimin e dëndur të natës, në komisionin mjekoligjor, në poliklinikë, në shkollën e infermierëve dhe ndihmës mjekëve, me ambulancat e ndërmarrjeve ekonomike dhe tek pacientët në familje, larg çdo shpërblimi tjetër veç pagesës shtetërore duke qenë krenar në një jetesë shumë modeste. Në vitin 1971 dërgohet mjek në spitalin e Dukagjinit ku pavarësisht nga vështirësitë e zonës e

të tijat familiare, punon po me atë përkushtim që ishte pjesë e edukatës së tij të punës. Dr. Bala dha gjithshka mund të jepet nga një qytetar, nga një mjek. Ai nuk njohu kufizim në orët e punës, nuk njohu të djela festash por me një përkushtim të veçantë u gjend gjithnjë në krye të detyrës, pranë të sëmurëve.

Me kolegët e tij mjekë, infermierë e sanitarë u bë mik, shok e mësues i vërtetë, duke pëcjellë tek ato të gjitha vlerat që ai mishëroi, sidomos përkushtimin, edukatën e punës dhe aftësitë profesionale. Puna shumëvjeçare, kualifikimi në klinikat universitare dhe natyra e tij prej studiuesi të vërtetë e spikatën si mjek duke rritur autoritetin e tij dhe të institucionit që ai drejtonte. Veçohej si mjeku që nuk rreshtte së studiuar.

Ai ishte një arshivë më vehte e një materiali të pasur hulumtuesh dhe përfundimesh teorike por dhe të konkluzioneve të nxjerra nga vëzhgimet klinike. Dr. Bala ka qenë një kumtues i admirueshëm temash mjeksore, një diskutant pasionant e dashamirës në kujtesat e kolegëve si dhe një vëzhgues i kujdesshëm për të rejat në fushën e mjeksisë me synim zbatimin e tyre në praktikën mjeksore. Personaliteti i Dr. Balës është i shprehur në disa drejtime e që meriton të bëhet objekt i një njohjeje më të thellë.

Muhamet Bala rrjedh nga një familje shkodrane e mirfilltë, që gjatë jetës së tij do ta orientojë drejt prirjeve demokratike dhe rrugës së progresit. Në vitet e gjimnazit, si dhe ato të universitetit është veçuar për rezultate të larta dhe shquhet për prirje letrare, duke medituuar në frymën migjeniane dhe të Gaspër Palit. Qe bashkëkohës, bashkëpunëtor dhe me vlerësime të ndërsjellta me Arshi Pipën, Sami Repishtin, Qemal Draçinin dhe Llazar Siliqin. Shpejt formon personalitetin e tij letrar dhe si i tillë ngarkohet nga

rinia gjimnaziste për të mbajtur fjalën e lamtumirës mbi varrin e Gaspër Palit, mësuesit të tyre të madh. Pas mbarimit të gjimnazit, fiton në konkursin kombëtar për "Filozofia pura" dhe fillon studimet në universitetin e Firences, por vetëm për një vit sepse kthehet në atdhe pas thirrjes që u bë për rezistencë në luftë kundër pushtuesit. Gjatë luftës zhvilloi veprimtari klandestine. Asnjëherë në vitet më pas nuk pranoi të shfrytëzonte veprimtarinë e tij të luftës për fasadë. Pas çlirimit hipën në skenë me cilësinë e aktorit në teatrin amator, punon redaktor në gazetën lokale "Koha e Re", redaktor për lajmet e jashtme në Radio Shkodra; do të jetë i pari drejtues i bibliotekës së shtetit në Shkodër.







Asnjë herë nuk i është ndarë krijimtarisë letrare që nga fillimet e tij në revistën "Fryma" ku ishte redaktor e deri në fund të jetës shkroi poezi, ese, kritikë letrare dhe prozë poetike ku veçohet "Mësuesi im". Qe njohës i shumë gjuhëve të huaja, të italishtes, frëngjishtes, latinishtes, sërbo-kroatishtes, hungarishtes, rusishtes, dhe më vonë studioi turqishten e gjermanishten. Dorëshkrimet e shumta, që në pjesën më të madhe janë të pabotuara, përfshijnë fushën e mjeksisë, linguistikës, me fjalorët Italisht - Shqip, të Frazellogjisë shqipe, të fjalëve të urta, në fushën e letërsisë, atë të përkthimit, presin të zbulojnë atë krijimtari të pasur që ende nuk njihet. Njeri me ndjenja të thella qytetare, me shpirt e zemër demokrate e atdhetari, me formim të gjerë kulturor, punëtor e i palodhur, pa vese, korrekt, tolerant, konsequent në bindjet. Të tillë e njohën dhe e kujtojnë përherë Dr. Muhamet Balën.

VO: Kumtuar me rastin e vlerësimit me titullin "Krenaria e Qytetit" të Shkodrës.

Shkodër, më 17 shtator 2001.

PROGRESI

BOTIME



Adresa Shqipëri
 L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi / Shkodër
 Tel: +355 69 20 76768 / +355 67 20 86767
 e-mail: revistaetika@hotmail.com

Adresa Kosovë
 Ardian Zurnaciu / Marash / Prizren
 Tel: +377 44 337582
 e-mail: orhan_s22@hotmail.com

Space-center

Qendra e internetit space-center ju ofron:

- internet te shpejte,
- shperndarje interneti,
- programe te ndryshme,
- cd, dvd, mp3,
- servis kompjuterash
- printime, skanime, etj.

Te gjitha keto me nje sherbim cilesor e te kulturuar.
Jemi hapur cdo dite nga ora 08:00 deri 23:30.

Adresa: pallati xhenis pas rektoratit te universitetit
"luigj gurakuqi", kati I

Kontakte:

- e-mail: spacecenter@live.com
- Cel. 0693253723 / 0672944162

RASMUNDSEN PER BOTEN ISLAME

Sekretari i ri i përgjithshëm i Natos, Rasmunden, sapo është zgjedhur në postin e rëndësishëm të Sekretarit të përgjithshëm të Natos si njeri i besueshëm i amerikanëve, sidomos e lidhjeve shumë të ngushta me ish-presidentin, Bush, të cilin e mbështeti me trupa ushtarake në aventurat e rrezikshme që Bush ndërmoi në Irak dhe në Afganistan. Por, Rasmundsen është i njohur edhe për qëndrimin e tij të pa precedent në mbështetje të karikaturave që bënë mediat daneze dhe ato evropiane kundër profetit, Muhamedit a.s.,

duke i motivuar ata me lirinë e mediave, në një kohë që po të penalizosh dhe të vësh në dyshim holokausin do të përballësh me dënime të ashpra të shoqëruara edhe me afate të gjata burgimi si fyerje për viktimat e holokaushit. Ishin këto karikatura që u bënë nga një revistë daneze që ngritën një stuhë demonstratash në të gjithë botën islame, sepse karikaturat për muslimanët u konsideruan me të drejtë një fyerje për vetë fenë islame, duke pasë parasysh se karikaturat ishin pikërisht kundër profetit të fesë islame. Në momentin, kur u prezantua kandidatura e Rasmundsenit për postin e

lartë në Nato, kryeministri i Turqisë, Taip Rexhep Erdogan, e kundërshtoi me forcë kandidaturën, duke e paraqitur si të rrezikshme për Botën islame, sepse me qëndrimin e tij ndaj botimit të karikaturave, Rasmundsen ishte pozicionuar si armik i botës islame. Prandaj, pasi mori detyrën e lartë në Nato, Rasmundsen ka deklaruar se do të mbrojë muslimanët dhe dëshëron që t'ua shtrëngojë duart në shenjë miqësie. Të shohim në të ardhmen sa do të jenë reale këto deklarata të sekretarit të ri të Natos, sepse është kjo figurë e njohur politike që ka kontingente të mëdha trupash ush-

tarake, në kahasim me popullsinë, në vatra të nxehta lufte si: Iraku dhe Afganistani, ku armët janë drejtuar drejt muslimanëve, duke sjellë shkatërrimin e këtyre vendeve dhe vrasjen e vazhdueshme të civilëve. Mbështetja më e mirë që Rasmundsen do t'u kishite dhënë muslimanëve do të kishte qenë tërheqja e trupave të Aleancës nga Afganistani, duke u dhene fund luftimeve dhe duke ndaluar vrasjet e civilëve të pafajshëm.

Alban Kastrati